


REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

ANALIZË STATISTIKORE

SHKURT 2021

Tiranë

Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas

Drejtoria e Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Juridike Parësore

LËNDA

HYRJE	5
KREU I: Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	7
KREU II: Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara.....	13
KREU III: Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	19
KREU IV: Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010.....	22
KREU V: Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	26
SHTOJCË: Ndhma juridike parësore Janar- Shkurt 2021.....	31

© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo forme.

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.

Referuar nenit 8 shkronja “nj”, të ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”**.

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

- a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti;
- b) Të dhënave të regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mbledhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti **i dërgojnë periodikisht çdo muaj Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas**, të dhënat e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve kërkuese të paraqitura për të përfituar ndihmë juridike të garantuar nga shteti. **Të dhënat dërgohen brenda 5 (pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.**

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. Emri, atësia, mbiemri,
- ii. Gjinia,
- iii. Datëlindja,
- iv. Shtetësia,
- v. Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- vi. Gjendja e punësimit,
- vii. Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- viii. Vetëdeklarimi në lidhje me të ardhurat dhe pasuritë,

- ix. Nëse kërkesa për ndihmë është pranuar apo refuzuar, si dhe arsye e refuzimit,
- x. Natyra e çështjes/ve juridike për të cilën është kërkuar ndihmë (civile, administrative, penale),
- xi. Të dhënat e ofruesit të shërbimit që ka dhënë ndihmë juridike parësore.

Ndërsa në regjistrin e organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- i. Emërtimi i organizatës jofitimprurëse, përfaqësuesit të saj ligjor dhe të dhënat e kontaktit,
- ii. Të dhëna mbi vendimin e Ministrit të Drejtësisë për autorizimin e organizatës jofitimprurëse;
- iii. Juridiksioni ose zona gjeografike ku organizata jofitimprurëse është autorizuar të japë ndihmë juridike parësore, si dhe specifikime të tjera mbi llojin e ndihmës parësore për të cilën është autorizuar,
- iv. Të dhëna mbi kontratën e financimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore, nëse ka lidhur një kontratë të tillë,
- v. Të dhëna për revokimin e autorizimit të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, sipas rastit.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese dhe i organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike falas mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

- *Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas*

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas autorizon me shkrim një punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

KREU I- ANALIZË STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE TË TRAJTUARA NGA QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndhimja juridike parësore jepet nga: *Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Shkurt 2021, Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas administron 9 (nëntë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si vijon:


- ❖ **Tiranë** (në bashkëpunim me OSFA në kuadër të projektit: “Qendrat e Ndhimës Juridike parësore në Tiranë”);
- ❖ **Durrës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lezhë**; (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit)
- ❖ **Shkodër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Gjirokastrë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)

❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Viktima Dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Tiranë	59	-	59	18	41	59	-	9	7	43	33	9	17	1	-
Lezhë	8	-	8	8	-	8	-	7	-	1	7	-	1	3	-
Durrës	20	-	20	12	8	20	-	10	10	-	13	4	3	1	-
Lushnje	17	-	17	11	6	17	-	10	7	-	8	-	9	-	-
Shkodër	40	-	40	21	19	40	-	28	12	-	35	-	5	1	6
Gjirokastrë	28	-	28	8	20	28	-	12	13	3	19	1	8	12	1
Pogradec	36	-	36	22	14	36	-	10	21	5	22	6	8	4	-
Fier	4	-	4	2	2	4	-	4	-	-	3	-	1	1	-
Dibër	4	-	4	3	1	4	-	4	-	-	1	-	3	1	-
TOTALI	216	-	216	105	111	216	-	94	70	52	141	20	55	24	7


Për muajin Shkurt janë administruar 216 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore.

Rastet për muajin SHKURT /Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore




**TË DHËNA STATISTIKORE MBI NATYRËN E PROBLEMATIKAVE TË RAPORTUARA
(QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE)**

Rastet e raportuara nga Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore




**TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E SUBJEKTEVE PËRFITUES SIPAS GJINISË
(QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE)**

Numri i subjekteve përfitues



TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E SUBJEKTEVE PËRFITUES SIPAS KATEGORIVE PËRFITUESE (QENDRAT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE)

Numri i subjekteve përfitues



■ Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ■ Kategori të Veçanta ■ Papërcaktuar

KREU II- ANALIZË STATISTIKORE E RASTEVE TË RAPORTUARA NGA ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA

Organizata Jofitimprurëse e Autorizuar	Totali i Rasteve	Mosha		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes		
		Mitur	Rritur	F	M	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe të pasuri pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Admin
“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza” ¹	15			15	0	15	0	0	7	8 (viktima të dhunës në familje)	0	10	2	3
“Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	10			6	4	10	0	0	-	-	10	0	0	10
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara” ²	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
“Intelektualët e rinj shpresë”	2			2	0	2	0	0	0	1 (person me aftësi të kufizuar)	1	2	0	0
CRCA	0			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
“Forumi i Gruas Elbasan”	8			8	0	8	0	0	0	8	0	8	0	0

¹ 47 raste të trajtuara për muajin Shkurt 2021, përmes linjes telefonike 116117


“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	41			24	17	30	0	11	41	0	0	24	0	17
“Të ndryshëm dhe të barabartë”	11			11	0	11	0	0	0	11 (4 viktima trafikimi; 6 viktima të dhunës në familje; 1 viktimë e abuzimit seksual)	0	5	4	2
“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	34			17	17	34	0	0	7	22 (10 persona përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale; 4 viktima të dhunës në familje; 8 persona me aftësi të kufizuar)	5	16	3	15
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	42			38	4	42	0	0	20	22 (18 viktima të dhunës në familje; 4 pensionistë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale)	0	35	3	4
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	8			2	6	0	8	0	0	0	8	0	0	8
“Qendra Konsumatori Shqiptar” ³	8			4	4	8	0	0	0	0	8	6	0	2
TOTAL	179⁴			127	52	160	8	11	75	72	32	106	12	61

Për muajin SHKURT janë administruar 179 raste nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara


³ 4 raste me karakter publik

⁴ Nga 12 OJF-te e autorizuara janë raportuar vetem 3 raste të trajtuara për kategoritë Rome dhe Egjiptiane për muajin Shkurt 2021.


Numri i rasteve të raportuara




**TË DHËNA STATISTIKORE MBI NATYRËN E RASTEVE TË RAPORTUARA ORGANIZATAT
JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA**



**TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E SUBJEKTEVE PËRFITUES SIPAS GJINISË
(ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA)**



TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E SUBJEKTEVE PËRFITUES SIPAS KATEGORIVE PËRFITUESE (ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA)



KREU III- ANALIZË STATISTIKORE E RASTEVE TË RAPORTUARA NGA KLINIKAT E LIGJIT PRANË IAL-VE ME TË CILAT DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS KA LIDHUR MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 10 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

- 1.Fakulteti i Drejtësisë;**
- 2. Kolegji Universitar “Ëisdom”;**
- 3. Klinika e Ligjit Shkodër (Hapur nga OSFA);**
- 4.Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;**
- 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;**
- 6.“Universiteti Europian i Tiranës”;**
- 7. “Universiteti “Qirjazi”**
- 8. Universiteti “Bedër”**
- 9. Universiteti “Mesdhetar”**
- 10. Universiteti “Marin Barleti”**

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfutuar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas

standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Klinikat e ligjit ⁵	Totali i Rasteve të trajtuara	Mosha		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Cështjes			Përkatësia Etnike	Viktima dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Vecantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Kolegji Universitar Ësdom	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji universitar Bedër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji Universitar Qiriazi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Mesdhetar	2	-	2	1	1	2	-	2	-	-	1	-	1	-	-
Universiteti Europjan i Tiranës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Klinika e ligjit në Shkodër hapur nga OSFA	10	-	10	8	2	10	-	10	-	-	2	-	8	-	-

⁵ Klinikat e tjera nuk kanë pasur raste

Universiteti "Marin Barleti"														-	-
TOTALI	12	-	12	9	3	12	-	12	-	-	3	-	9	-	-

Për muajin SHKURT janë administruar 12 raste nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.

KREU IV- ANALIZË STATISTIKORE E ÇËSHTJEVE TË TRAJTUARA NË PLATFORMËN JURISTIONLINE

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundësuar për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojëshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e sukseshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfutimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistike që mund të pasqyrojnë përkojnë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)

Rastet e trajtuara SHKURT 2021

Natyra e çështjeve/lloji i problematikave

Rastet e lidhura me gjendjen e fatkeqësisë natyrore si pasojë e pandemisë_COVID -19 0

Çështje CIVILE 112


Çështje PENALE 17

Çështje ADMINISTRATIVE 60

Kërkesë për informacione të ndryshme 14

Kërkesë për ndihmë juridike dytësore 0

TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA 203



TË DHËNA STATISTIKORE MBI RASTET E RAPORTUARA NGA NUMRI I GJELBËR

08001010


Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. *Si platforma juristonline ashtu edhe linja e gjelbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.*

Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.


Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashirojnë problematikën e tyre thjesht përmes një telefonate, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojnë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative).

NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA
TOTALI I RASTEVE 61


KREU V-: TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E RASTEVE TË RAPORTUARA NGA OFRUESIT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE



TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E RASTEVE TË RAPORTUARA NGA ÇDO OFRUES I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE (SIPAS GJINISË)




TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E RASTEVE TË TRAJTUARA NGA ÇDO OFRUES I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE (SIPAS NATYRËS SË ÇËSHTJES)




TË DHËNA STATISTIKORE MBI NUMRIN E RASTEVE TË TRAJTUARA NGA ÇDO OFRUES I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE (SIPAS KATEGORISË PËRFITUESE)

Numri i subjekteve perfitues



**TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA NGA OFRUESIT E SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE
PARËSORE PËR MUAJIN SHKURT 2021**

671 raste



SHTOJCË 1

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- SHKURT 2021

Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore

Totali i rasteve të raportuara: 385

Organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Totali i rasteve të raportuara: 400

Platforma juristionline.al

Totali i rasteve të raportuara: 371

Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Totali i rasteve të raportuara: 15

Numri i gjelbër

Totali i rasteve të raportuara: 137